



3. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Enti Rregullator i Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 450, datë 15.6.2016

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË "NXITJA E BIZNESIT SOCIAL" SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 20, të statutit të shoqërisë "Nxitja e biznesit social" sh.a., miratuar me vendimin nr. 391, datë 1.6.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit të shoqërisë "Nxitja e biznesit social" sh.a", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. En Muçi emërohet administrator i shoqërisë "Nxitja e biznesit social" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 451, datë 15.6.2016

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR TE BASHKIA POLIÇAN, TË QENDRËS POLIVALENTE PËR SHËRBIME TË PËRKUJDESIT SHOQËROR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1324, DATË 1.10.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, TË NDËRTESESË SË ISH-SPITALIT, POLIÇAN, DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 60, DATË 1.2.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT

TË PRONAVE SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja "d", 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror te Bashkia Poliçan, të pronës me nr. 32, me emërtimin "Qendra Polivalente për Shërbime të Përkujdesit Shoqëror", sipas formularit dhe planimetrisë bashkëlidhur, për t'u përdorur për shërbime të përkujdesit social për kategoritë në nevojë.

2. Bashkisë Poliçan i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e pronës të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr. 1324, datë 1.10.2008, të Këshillit të Ministrave.

4. Insitucioni, i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, dhe shërbimi shoqëror që ofrohet, transferohen bashkë me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin, personelin dhe dokumentacionin përkatës.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e grupit 25, titulli 10430, kap.1, artikulli 600, 601 dhe 602, të buxhetit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të miratuar për vitin 2016 dhe, në vijim, sipas vitit buxhetor përkatës.

6. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryetari i Bashkisë Poliçan dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 22045 Prot.

Tiranë, më 25/11 /2020

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Nr. 153 Datë 25/11 /2020

PËR

EMËRIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare”, i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 570, datë 03.10.2018 “ Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore”, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Nxitja e Biznesit Social” sha , Tiranë:

VENDOSA

1. Emërimin në detyrën e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë “Nxitja e Biznesit Social” sha Tiranë;
 - Znj. Adriana Sheti;
 - Znj. Alketa Braçe
 - Znj. Jonida Hoxha
2. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar“ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

22044
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 25/11/2020

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 152 Datë 25/11/2020

PËR

**EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË “NXITJA E BIZNESIT SOCIAL” SHA
TIRANË**

Mbështetur në Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare” i ndryshuar, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe statutit të shoqërisë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Nxitja e Biznesit Social” sha, Tiranë:

VENDOSA

1. Emërimin e Znj. Ulpiana Hysaj në detyrën e Administratorit të shoqërisë “Nxitja e Biznesit Social” sha, Tiranë.
2. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, të ndryshuar, Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistrë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

